



N J O F T I M **për realizimin e trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e** **aktiviteteve të brokerimit në sigurime**

Agjencioni i Mbiqëqyrjes së Sigurimeve informon publikun se do të organizojë trajnim dhe provim profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime (në tekstin e mëtejshëm: trajnim dhe provim profesional për broker).

Trajnimi për broker në një periudhë prej 4 ditësh (gjithsejt 27 orë mësimi) do të realizohet në periudhën 22-24.3.2018 dhe 31.3.2018, në ambientet e "Universitetit European" i cili gjendet në Bul. "Klimenti i Ohrit" nr.68 në Shkup.

Datat e sakta dhe orari i detajuar i ligjëratave në kuadër të trajnimit, si dhe datat e sakta dhe orari i detajuar për mbajtjen e provimit do të publikohen në faqen e internetit të Agjencionit të Mbiqëqyrjes së Sigurimeve para fillimit të trajnimit gjegjësisht provimit.

Pas përfundimit të trajnimit, Agjencioni do të realizojë provim profesional për broker. Datat për dhënien e provimit profesional për broker janë në vazhdim:

Pjesa e parë (pjesa teorike) më datë 19.4.2018
Pjesa e dytë (shembull praktik) më datë 4.5.2018

Kandidatët të cilët nuk do të kalojnë provimin profesional për broker në afatin e parë kanë të drejtën e dy riprovimeve në afat prej 6 muajve nga dita e përfundimit të trajnimit edhe atë në afatet e mëposhtme:

Afati i dytë
Pjesa e parë (pjesa teorike) më datë 14.5.2018
Pjesa e dytë (shembull praktik) më datë 31.5.2018.

Afati i tretë
Pjesa e parë (pjesa teorike) më datë 4.6.2018.
Pjesa e dytë (shembull praktik) më datë 19.6.2018.

Provimi profesional për broker do të zhvillohet në Qendrën e Provimit që gjendet në pjesën e biznesit të Sallës së Sporteve në kampusin universitar të Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup.

Bashkëngjitur është harta me vendndodhjen e saktë të objektit.

<https://goo.gl/maps/6dpaEa4GKF92>

Kandidatët të cilët me sukses e kalojnë provimin profesional për broker do të marrin Certifikatë për dhënien e provimit profesional për broker.

Kandidatët të cilët nuk e kalojnë provimin profesional për broker tre herë rradhazi, humbasin të drejtën e riprovimit të paraparë nga trajnimi.

Në trajnimin për broker përfshihen 9 (nëntë) fusha – module edhe atë:

1. Bazat e menaxhimit të riskut dhe sigurimit;
2. Legjislacioni në fushën e sigurimeve;



3. E Drejta Tregtare dhe e Detyrimeve;
4. Avokimi i Sigurimeve dhe Kodi i Etikës;
5. Sigurimi i jetës;
6. Sigurimi i jo-jetës;
7. Aspektet financiare të punës;
8. Regjistrimi i rreziqeve dhe ndërmjetësimi gjatë realizimit të dëmit; dhe
9. Risigurimi.

Përmbajtja e detajuar e secilit modul të trajnimit për broker është e zhvilluar në Programin mësimor për dhënie të provimit profesional për broker të cilën e përcakton Agjencioni dhe që përmban materialet e trajnimit, rregullat dhe literaturën. Programi mësimor është publikuar në faqen e internetit të Agjencionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Mënyra dhe procedura e realizimit të trajnimit dhe provimit profesional për broker detajisht është përshkruar në Rregulloren mbi mënyrën dhe procedurën e realizimit të trajnimit për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2015 dhe 16/2017) dhe Rregulloren mbi mënyrën dhe procedurën për realizimin e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/2014 dhe 16/2017).

Tarifa për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënie të provimit profesional për broker është përcaktuar në Tarifën për përmbajtjen dhe shumën e kompenzimeve dhe shpenzimeve që i kërkon Agjencioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe afateve të pagesës ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 147/2009, 149/2009, 154/2009, 20/2012, 130/2013, 1/2015, 22/2016 dhe 16/2017) dhe i njëjti arrin **14.000 denarë**.

Për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënie të provimit profesional për broker, personi duhet të plotësojë kushtet në vijim:

1. të ketë të kryer arsim të mesëm katërvjeçar;
2. të njohë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik; dhe
3. të mos ketë kryer funksionin e personit me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në ndonjë shoqëri sigurimi apo në ndonjë person tjetër juridik mbi të cilin është hapur procedurë falimentimi.

Të gjithë personat e interesuar, **jo më vonë se 02/03/2018**, mund të aplikojnë për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënie të provimit profesional për broker duke paraqitur dokumentet në vijim (me shënimin: Aplikim për trajnim/Kërkesë për dhënie të provimit për broker) Agjencionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (Adresa: Makedonija pn - Pallati Lazar Pop Trajkov, kati V, Shkup):

1. Formular të plotësuar - Aplikim për pjesëmarrje në trajnim për broker/Kërkesë për dhënie të provimit profesional për broker (në dispozicion në faqen e internetit të Agjencionit, www.aso.mk, ose në arkivin e Agjencionit);
2. Kopje të letërnjoftimit;
3. Çertifikatë gjegjësisht Diplomë për arsim të mesëm katërvjeçar të kryer (niveli IV) apo nivel më të lartë arsimor, në origjinal apo të vërtetuar nga personi i autorizuar - noteri;
4. Deklaratë që personi nuk ka kryer funksionin e personit me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në ndonjë shoqëri sigurimi apo në ndonjë person tjetër juridik mbi të cilin është hapur procedurë falimentimi, të vërtetuar nga personi i autorizuar - noteri; dhe
5. Dëshmi të pagesës së kompenzimit për pjesëmarrje në trajnim dhe për dhënie të provimit profesional për broker.



Nëse personi ka përfunduar shkollimin e tij jashtë vendit, përveç dokumenteve të përmendura më lartë, duhet të dorëzojë edhe Certifikatë të njohes aktive të gjuhës maqedonase të lëshuar nga Fakulteti Filologjik pranë Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi"- Departamenti i gjuhës maqedonase dhe gjuhëve sllave të jugut.

Nëse emri personal dhe mbiemri në ndonjërin nga dokumentet e përmendur më sipër nuk janë identik me ato të listuara në Aplikim/Kërkesë, personi duhet t'i bashkëngjese kërkesës edhe Certifikatë kurorëzimi apo Vendim për ndryshim të emrit personal gjegjësisht mbiemrit.

Dëshmia për pagesën e kompenzimit duhet t'i përmbajë të dhënat në vijim:

BAZA-QËLLIMI I PAGESËS:	Pjesëmarrje në trajnim dhe dhënie të provimit profesional për broker
EMRI I PRANUESIT:	Agjencioni i Mbiqëqyrjes së Sigurimeve - Shkup
BANKA E PRANUESIT:	Stopanska banka Sha - Shkup
LLOGARIA:	200002007041251 apo
BANKA E PRANUESIT:	NLB Banka Sha - Shkup
LLOGARIA:	210065288480132

Informata të detajuara për mënyrën dhe procedurën e realizimit të trajnimit dhe provimit profesional, Programin arsimor, datat e sakta dhe vendin e mbajtjes së trajnimeve dhe provimeve profesionale, mund të gjeni në faqen e internetit të Agjencionit të Mbiqëqyrjes së Sigurimeve (www.aso.mk) apo në numrin e telefonit: 02 3254-050.

VËREJTJE:

Për shkak të kapaciteteve të kufizuara për realizimin e provimeve profesionale, pjesëmarrja në trajnim gjegjësisht provim do të realizohet në përputhje me parimin "arrin i pari-shërbehesh i pari".

Aplikimet/kërkesat për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënie të provimit profesional që do të dorëzohen pas plotësimit të numrit maksimal të kandidatëve të mundshëm, si dhe aplikimet/kërkesat që do të dorëzohen pas afatit të fundit për dorëzimin e tyre, nuk do të merren parasys.

AGJENCIONI I MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

Përgaditi: Berat Murati
Kontrolloi: Mimoza Çkaleska Kartalova dhe Boban Stojanoviç
Pajtohet: mr. Biljana Janevska Nedellkovska
Aprovoi: Lulzim Imeri